**VENDIM**
**Nr. 549, datë 31.7.2019**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike".

b) Në fund të shkronjës "a", të pikës 1/3, shtohet emërtesa "Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore".

c) Në shkronjën "b", të pikës 1/3:

i. shtohen emërtesat "Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve" dhe "Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit";

ii. shfuqizohen emërtesat "Agjencia e Shërbimit Arkeologjik" dhe "Instituti i Monumenteve të Kulturës";

iii. emërtesa "Muzeu Kombëtar "Gjethi" zëvendësohet me emërtesën "Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"";

iv. emërtesa "Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" zëvendësohet me emërtesën "Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".

ç) Në shkronjën "c", të pikës 1/3:

i. shtohet emërtesa "Qendra Muzeore Durrës";

ii. emërtesa "Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat" zëvendësohet me emërtesën "Qendra Muzeore Berat - Muzeu i Ikonografisë "Onufri", Muzeu Etnografik Berat";

iii. emërtesa "Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti" Krujë" zëvendësohet me emërtesën "Qendra Muzeore Krujë - Muzeu Kombëtar "Skënderbeu", Muzeu Etnografik Krujë";

iv. emërtesa "Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë" zëvendësohet me emërtesën "Muzeu Kombëtar i Pavarësisë";

v. emërtesa "Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë" zëvendësohet me emërtesën "Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar";

vi. emërtesa "Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore" zëvendësohet me emërtesën "Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore";

vii. emërtesa "Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike" zëvendësohet me emërtesën "Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale";

viii. shfuqizohet emërtesa "Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit".

d) Pika 4/2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"4/2. Në Kryeministri, nëpunësit civilë në pozicionet, "Drejtor i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes", "Drejtor i Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë", "Drejtor i Departamentit të Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit", "Drejtor Njësie, Jurist dhe Koordinator në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë", "Drejtor Njësie, Drejtor Drejtorie dhe Koordinator në Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes", "Drejtor njësie dhe Koordinator në Njësinë e Transparencës dhe Antikorrupsionit", "Drejtor i Njësisë së Burimeve Kombëtare për Zhvillim", "Drejtor i Njësisë së Buxhetit dhe Administrimit", "Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Brendshëm" dhe "Koordinator në Sektorin (Zyrën) e Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm", në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.".

dh) Në pikën 5, pas fjalëve "Specialist redaktor në Kuvendin e Shqipërisë" shtohen fjalët "dhe "Specialist stenograf redaktor në administratën e Presidentit".

e) Në lidhjen nr.6/5, që përmendet në pikën 9.5, shtohen dy rreshta, me këtë përmbajtje:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes | III-a | 1 | 20 000 |
| Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse | III-a | 1 | 0 |

Zbatimi i këtij vendimi dhe efektet financiare që rrjedhin prej tij, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë nga:

i) momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve/punonjësve në strukturat dhe organikat e reja të institucioneve të përmendura në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij vendimi;

ii) momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për të gjitha përcaktimet e tjera.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**